

LIGJ
Nr. 32/2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 102/2014 “KODI DOGANOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 213, pika 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Magazinat doganore private konsiderohen edhe “dyqane të çliuara nga detyrimet” (duty free shops) që autorizohen të hapen në aeroportet për fluturime ndërkombëtare, portet për destinacionet ndërkombëtare dhe pikat kufitare tokësore, që ndodhen në zonën doganore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat, rregullat, mënyrën dhe kriteret e dhënies dhe numrin e autorizimeve për “dyqanet e çliuara nga detyrimet” (duty free shops), si dhe kushtet, të drejtat, detyrimet dhe afatet.”.

Neni 2

Në nenin 289, pika 2, pas numërimit “16” shtohen fjalët “pikat 4 dhe 5 të nenit 199,”.

Neni 3

Në nenin 291, pika 2, pas fjalëve “dhe 288” shtohen fjalët “fjalia e dytë e pikës 2 të nenit 213”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9052, datë 20.4.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani